



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 66/16
Prishtinë, më 1.8.2016, ora 16:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Adem Grabovci, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta dhe Fikrim Damka.

Munguan: Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontić, Shqipe Pantina Bali Muharremi dhe Enver Hoti.

Pjesëmarrës të ftuar: Bedri Hamza - Guvernator i BQK-së dhe Avdullah Hoti - Ministër i Financave, Mentor Shala - Drejtor i Përgjithshëm në RTK, Adelina Valla - Udhëheqëse Financiare në RTK, Udhëheqës së Shërbimeve të Përbashkëta në RTK, Fatmir Gërvalla nga ARKEP, Shafi Gashi Kryesues i Këshillit të KKTK-së, Arjeta antëare e Këshillit të KKTK-së, Gjejlane Hoxha nga KKTK, Hilmi Demolli nga KKTK.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Rejhane Zylfijaj nga GIZ, Fjolla Uka - monitoruese në KDI, gazetar nga Koha Ditore, gazetar nga Rrokum TV.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Isein, dhe Nora Kelmendi (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 6.7.2016, 11.7.2016 dhe 13.7.2016;
3. Shqyrtimin i Projektligjit nr.05/L-111 për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin e Rehabilitimit të Linjës Hekurudhore 10;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-112 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Garancisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin e Trafikut Urban;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-066 për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Kosovës dhe amendamenteve të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport;

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-24 për Shërbimin Mjekësor Emergjent dhe amendamenteve të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;
7. Shqyrtimi i Raportit financiar të Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën prill-qershor 2016 dhe Programit të Shpenzimeve të RTK-së, për periudhën korrik-shtator 2016;
8. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2015;
9. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor për vitin 2015;
10. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-088 për rregullat e komunikacionit rrugor dhe amendamenteve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;
11. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe amendamenteve të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport;
12. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari – theksoi se pika e 5 dhe 6 e rendit të ditës përmbajnë implikime buxhetore shtesë, për qfarë ka nevojë për konsultime shtesë me minitrinë e financave e cila duhet të bëjë vlerësimin e koston buxhetore të zbatimit të ligjeve, sidomos të amendamenteve të propozuara nga komisionet funksionale, të cilat vlerësohet se krijojnë kosto shtesë buxhetore.

Avdullah Hoti - projektligjet janë proceduar vitin e kaluar në Kuvend, sidomos pika e pestë, dhe ka nevojë për një vlerësim të ri të koston buxhetore, për të parë se qfarë është përfshirë në kornizën buxhetore aktuale dhe cila është kostoja shtesë.

Kryetari - propozojë që pika e 5 dhe 6 të shtyhen për shqyrtim në një mbledhje tjetër të komisionit, në muajin shtator.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht vendosi që pika 5 dhe 6 të shtyhen për në një mbledhje tjetër të komisionit.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 6.7.2016, 11.7.2016 dhe 13.7.2016;

Kryetari – konstatoi se procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 6.7.2016, 11.7.2016 dhe 13.7.2016, miratohen pa vërejtje.

3. Shqyrtimin i Projektligjit nr.05/L-111 për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin e Rehabilitimit të Linjës Hekurudhore 10;

Kryetari – Projektligji, ka për qëllim të ratifikojë Marrëveshjen Financiare të nënshkruar me Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin e Rehabilitimit të Linjës Hekurudhore 10.

Avdullah Hoti – sqaroi se kostoja totale e projektit të rehabilitimit të linjës hekurudhore 10 do të jetë 195.5 milion euro, përfshirë TVSH-në dhe taksat tjera. Projekti përfshinë pjesën nga Hani Elezit deri në veri në kufi me Serbinë apo në Leshak. Kredia me Bankën Evropiane Investive që po diskutojmë

përfshin shumën prej 42 milion euro. Kushtet e kredisë janë të favorshme. Ka një periudhë kthimi prej 25 viteve, një grejs periudhë prej 4 vitesh. Norma është 1% dhe Eurobori gjashtëmuor që është minus. Kredia do të nën-huazohet tek Ndërmarrja Publike Infrakos dhe është pjesë e Klauzolës së Investimeve.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni unanimisht, nxori këtë

Rekomandim

Komisioni i rekomandojë Kuvendit miratimin e Projektligjit nr.05/L-111 për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin e Rehabilitimit të Linjës Hekurudhore 10.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-112 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Garancisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin e Trafikut Urban;

Kryetari – Projektligji, respektivisht marrëveshja ka për qëllim ta ratifikojë marrëveshjen për garanci ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për realizimin e projektit në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të transportit urban për qytetarët e Komunës së Prishtinës nëpërmjet përtëritjes së flotës së autobusëve. Projekti përbëhet prej tri pjesëve: rehabilitimi i depos për mirëmbajtje të kredimarrësit, blerja deri në 30 autobus te rinj dhe blerja deri në 21 autobus të tjerë të rinj.

Avdullah Hoti – Projektligji ka të bëjë me ratifikimin e marrëveshjes për garanci shtetërore që është kërkuar nga kompania Trafiku Urban. Kemi kërkuar që komuna të jetë ndërmjetësues në këtë proces dhe pas vendimit të Kuvendit Komunal për garancinë e kthimit të kredisë që do ta merr Trafiku Urban, ne kemi vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore dhe si të tillë e kemi proceduar në Kuvend për ratifikim. Kredia ka maturitet 12 vite dhe 2 vite grejs periudhë. Kredia përfshinë normën standarde që ka BERZH-i prej 1%, plus norma gjashtëmuore e EUROBOR-it.

Kryetari – Kredia përbehet nga dy transha: Transha A në shume prej 6,206,897€ dhe Transha B në shume prej 3,793,103€. Me qëllim të harmonizimit të tekstit të projektligjit te tekstin e marrëveshjes, propozojë pesë amendamente, të natyrës teknike.

Adem Grabovci – pyeti lidhur me vonesën e procedimit të marrëveshjes, a ka ndodhur për shkak të pengesave të Komunës apo të Qeverisë?

Avdullah Hoti – në bazë të ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare dhe ligjit për borxhet publike, janë përcaktuar afatet apo hapat e garancisë së një marrëveshje. Në marrëveshjen në fjalë, ngecjet kanë ndodhur deri në nxjerrjen e vendimit nga Kuvendi Komunal i Prishtinës për garancinë e kredisë për Trafikun Urban.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni unanimisht, nxori këtë

Rekomandim

Komisioni i rekomandojë Kuvendit miratimin e Projektligjit nr.05/L-112 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Garancisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin e Trafikut Urban, me amendamentet si vijon:

Amendamenti 1

Në fund të titullit të Projektligjit, pas fjalës “Urban”, shtohet fjala “PRISHTINË”

Amendamenti 2

Neni 1, në rreshtin e tretë dhe të katërt, teksti “Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për zhvillim”, zëvendësohet me tekstin “Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim”.

Amendamenti 3

Neni 2, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 2

Ratifikimi i Marrëveshjes

Ratifikohet Marrëveshja e garancisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin e Trafikut Urban të Prishtinës.

Amendamenti 4

Neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1., riformulohet me tekstin si vijon:

1.1. Marrëveshja e garancisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për Projektin e Trafikut Urban të Prishtinës.

Amendamenti 5

Neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2., riformulohet me tekstin si vijon:

1.2. Marrëveshja për hua ndërmjet NPK Trafiku Urban dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për Projektin e Trafikut Urban të Prishtinës.

5. Shqyrtimi i Raportit financiar të Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën prill-qershor 2016 dhe Programit të Shpenzimeve të RTK-së, për periudhën korrik-shtator 2016;

Kryetari – Radiotelevizioni i Kosovës në pajtim me nenin 9, paragrafi 6 të Ligjit 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016 (i ndryshuar dhe plotësuar me nenin 8, të Ligjit nr.05/L-109), ka dorëzuar në Kuvend, Raportin gjashtëmujor financiar janar-qershor 2016 dhe Programimin e shpenzimeve të planifikuara për periudhën korrik-shtator 2016. Në baze të projeksioneve të RTK-së për periudhën korrik - shtator 2016, RTK-ja ka kërkuar transferin e mjeteve nga buxheti i Republikës së Kosovës në shume prej 2,400,000€, të hyrat nga marketingu i ka planifikuar të jene 500,000€ dhe të hyra tjera 50,000€.

Mentor Shala – fillimisht sqaroi se në pamundësi që të marrë pjesë në mbledhjen e komisioni, kryesuesi i bordit të RTK-së e ka autorizuar që të prezantojë në emër të RTK-së për pikën e rendit të ditës. Theksoi se jemi munduar me buxhetin aktual të kemi kursime edhe pse po na kushton edhe në program edhe në cilësi, që pastaj po përballemi me kritika.

Adelina Valla - theksoi se të hyrat e RTK-së për periudhën janar-qershor kanë qenë të parapara 5.9 milion euro, të ndara në tri kategori: të hyrat nga buxheti i Kosovës 4.5 milion euro, të hyrat nga marketingu 1 milion euro dhe të hyrat tjera 100,000 euro. Nga të hyrat e parapara, inkasimi ka qenë

6,023,778 milion euro dhe janë realizuar të hyra prej 123,000 euro më tepër se sa kanë qenë të parapara. Në kategorinë e shpenzimeve, kanë qenë të parapara 6,023,778 euro dhe janë realizuar 6,031,688 euro. Në paga dhe mëditje realizimi është 101,17%, mallra dhe shërbime 101.66%, shërbime publike 94.12% dhe investime kapitale 87.56%. Pra ka pasur një tejkalim prej 0.13% të buxhetit të planifikuar ose e shprehur në shumë totale 7,909 euro.

Besa Gaxherri – ju zotëri drejtor thatë se jeni të autorizuar nga kryesuesi i bordit, që për mua është e papranueshme, pasi që ju e keni vendin tuaj dhe në bazë të ligjit, kryetari është dashur me autorizue një anëtar të bordit që të prezantojë në Komision. Buxheti i RTK-së, respektivisht shpenzimet janë tejkaluar për 7.909 euro krahasuar me të hyrat. Më bënë përshtypje fakti se në paga dhe mëditje janë 38,690 euro më shumë se sa të planifikuara. Në investime kapitale 87.56% i keni shpenzuar dhe ju ankoni për kushtet e vështirë të punës gjë që qendron, por në anën tjetër shpezimet kapitale nuk arrini ti realizoni për qfarë janë të ndara. Kjo situatë është e papranueshme, pasi që për shumën prej 38.690 ose i keni rritur numrin e të punësuarve ose i keni rritur pagat ashtu siç keni dashur ju. Ndryshimet e mjeteve të investimeve kapitale dhe shërbimeve publike që e keni bartuar në paga dhe mëditje, nuk është ligjore dhe jo korrekte.

Kryetari - a ka mundësi një sqarim për rritjen e numri të punëtorëve nga 712 në 741, ndryshim i cili ka ndodhur vetëm për tremujor?

Mentor Shala - ne kemi pasur rekomandim prej inspektoratit të punës për shkak të kontratave mbi vepër të shëndrrohen në punëtor të rregullt. Gjithashtu kemi pasur të punësuar në menzaxhment dhe ka pasur nevoja për punëtor të rinj. Sa i përket punëtorëve, ne e kemi themeluar një grup strategjik për ta bërë një analizë të përgjithshme për RTK dhe do të hartojmë një dokument për të parë gjendjen aktuale dhe nevojat e punëtorëve të RTK-së. Problem është që të largohen njerëzit prej pune, ndërsa në anën tjetër kemi nevoja për punëtorë të rinj. Për këtë qëllim presim që analiza do të na paraqet gjendjen dhe nevojën e saktë në këtë drejtim. Aktualisht i kemi 743 punëtorë të punësuar në RTK.

Besa Gaxherri - zoti Shala e di që jeni nën presion prej politike sa i përket punësimeve. Por me 743 punëtor nuk mund të ankoheni sa nuk keni punëtorë të mjaftueshëm. Tjetër gjë është ajo që mund të keni punëtorë që nuk dinë me krye punën e tyre. Bordi dhe ju si menaxhment duhet të thoni se kaq është numri i punëtorëve, kaq janë të pa specilizuar dhe sa janë nevojat reale për punëtor profesionistë. Por po shifet nuk po e bëni punën e juaj, as ju e as bordi.

Fikrim Damka – lidhur me shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit i keni tejkaluar 13,000 euro dhe nuk i keni specifikuar shpenzimet e akomodimit. Si i keni shpenzuar këto mjete pa akomodim? Çështja e dytë ka të bëjë me blerjen e kapionatit evropian, ku i keni planifikuar 192,000 euro, ndërsa i keni shpenzuar 260,000 euro. A nuk e keni ditur koston e blerjes së transmetimit të këtij kampionati?

Mentor Shala – sa i përket udhëtimeve zyrtare në periudhën raportuese ka pasur shumë udhëtime zyrtare më të gjata se zakonisht. Janë udhëtimet në përcjelljen e zyrtarëve shtetëror në vizitat e realizuara jashtë vendit.

Adelina Valla – sa i përket mëditjeve jashtë vendit, gazetari ngarkohet e një shumë për të gjitha shpenzimet që i bënë. Sa i shumë për kapionatin evropian, është përfshirë edhe kostoja e kampionatit të basketbollit për meshkuj dhe femra.

Labiontë Demi-Murtezi – po e shof prap një vërejtje që kam bërë herën e kaluar. Disa emisione bllok me çmim të përbashkët, siç janë emisionet: Jeta në Kosovë, Drejtësia në Kosovë, Besimi në Drejtësi, Supersfida, Parrotlla, Ditari i Peshkatarit dhe nuk e dijmë për secilin emision veç e veç se çfarë çmimi

ka. Nuk mund të konsiderohet një raport financiar i rregulltë, ku gjashtë apo shtatë produkte janë me një çmim të përbashkët. Në këtë raport shifet se nuk keni bërë tejkalime në krahasim me planifikimet për këtë kategori, por besojë që herën tjetër duhet të pasqyrohen shpenzimet për secilin emision. Kam thënë edhe herën e kaluar se në bazë të numrit të punëtorëve që ka RTK, mund ta bëjë vetëm një emision të peshkatarit dhe jo që të blejë atë, që edhe ashtu është mjaftë i zbehtë.

Bardhyl Meta - theksoi se për dallim prej televizioneve private, televizioni publik ka obligime ligjore që duhet përmbushur dhe ato kanë koston e vetë. RTK-së asnjëherë nuk iu ka bërë kompensimi për ushtrimin e programit në gjuhën serbe dhe si rezultat për 13% është rritur kostoja e buxhetit të RTK-së. Ne kemi krijuar grupin punues të përbashkët të të dy komisioneve për të dalur me konceptin e ri për ndryshimet dhe plotësimet e ligjit rreth financimit afatgjatë të RTK-së në mënyrë që vitin e ardhshëm të kemi të rregulluar qështjen e funksionimit dhe financimit të transmetuesit publik.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni unanimisht, nxori këtë

Rekomandim

Komisioni i rekomadojë Ministrisë së Financave, respektivisht Drejtorit të përgjithshëm të Thesarit, të bëjë transferin e mjeteve buxhetore nga Llogaria e Fondit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës, nga buxheti i Radiotelevizionit të Kosovës - kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, në llogarinë e RTK-së nr.1110101219060187, për periudhën 1 Korrik – 30 Shtator 2016, në shumën prej 2,400,000 (dy milion e katërqind mijë) euro.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-088 për rregullat e komunikacionit rrugor dhe amendamenteve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastruktura, Tregti dhe Industri;

Kryetari - theksoi se projektligji dhe amendamentet e komisioni funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni unanimisht, nxori këtë

Rekomandim

Projektligji nr.05/L-088 për rregullat e komunikacionit rrugor dhe amendamentet të propozuara nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastruktura, Tregti dhe Industri, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe amendamenteve të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport;

Kryetari - theksoi se projektligji dhe amendamentet e komisioni funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni unanimisht, nxori këtë

Rekomandim

Projektligji nr.05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe amendamentet të propozuara nga Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

8. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2015;

Anëtari i Bordit të ARKEP-it – raporti financiar i ARKEP-it përmban të dhëna për të hyrat dhe shpenzimet për vitin 2015. Viti 2015 ka shënuar një numër të arriturash për ARKEP-in. Në vazhdim foli për aktivitetet përkatëse të këtij institucioni, që kanë ndikuar edhe në performancën e mirë të të hyrave që janë depozituar në buxhetin e Kosovës.

Kryetari - theksoi se Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, ka dorëzuar në Kuvend Raportin vjetor financiar për vitin 2015, i cili është hartuar sipas formularëve standard. Raporti përmban të dhëna për buxhetin e miratuar të Autoritetit për vitin 2015, ndryshimet që kanë ndodhur në ndryshimin e buxhetit gjatë vitit si rezultat i rishkimit të buxhetit të Kosovës dhe në bazë të vendimit të qeverisë, si dhe shpenzimet për kategoritë dhe nënkategoritë ekonomike, të prezantuara edhe në përqindje, si dhe krahasimet me vitin 2015. Në bazë të analizës së raportit financiar, shohim se kjo organizatë buxhetore ka menaxhuar mirë buxhetin, pasi që shpenzimi i buxhetit në total është 95.23%. Një realizimi i mirë i buxhetit, vërehet në të gjitha kategoritë ekonomike. Ndërkaq, nuk kemi pasur tejkalime të shpenzimeve në nënkategoritë ekonomike, edhe pse jo të gjitha shpenzimet e nënkategorive ekonomike janë prezantuar në përqindje.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni unanimisht, nxori këtë

Rekomandim

Komisioni i rekomandojë Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2015.

9. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2015;

Kryetari - në bazë të nenit 4, paragrafi 4.9 të Ligjit për Trashëgimin Kulturore nr. 02/L-88, Këshilli i Kosovës për trashëgimi kulturore do të identifikojë masat e domosdoshme të mbështetjes financiare për trashëgimi Kulturore për secilin vit nga Kuvendi i Kosovës në pajtim me këtë ligj. Raport pasqyron të dhënat për buxhetin e miratuar dhe shpenzimet e buxhetit sipas kategorive dhe nënkategorive ekonomike për vitin 2015, si dhe të dhëna për vitin 2014.

Shafi Gashi – prezantoi shpenzimet e buxhetit të Këshillit për vitin 2015, ku për paga dhe mëditje janë shpenzuar 83,977.04 euro, mallra dhe shërbime 64,471.75 euro, shpenzime komunale 2,095.27 dhe në total buxheti i shpenzuar është 150,544.06 euro. Rrogat e anëtarëve të Këshillit janë miratuar në vitin 2009 që janë shumë të ulta. Ajo që është e nevojshme të rregullohet më mirë qëshja e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit në bazë të kriterëve profesionale.

Besa Gaxherri – tek Këshilli nëse krahasojmë me agjencionet tjera të pavarura, ka diskriminim edhe tek pagat edhe tek buxheti. Me rastin e shqyrtimit të buxhetit 2017 ne duhet të analizojmë buxhetin e

Këshillit, por edhe ju si përfaqësues të këtij Këshilli të hartoni kërkesat në bazë të nevojave reale që keni.

Adem Grabovci – ne si komision jemi për t’iu mbështetur dhe bashkëpunuar, por nevojat dhe kërkesat e arsyetuara duhet të hartohen nga ju. Ju duhet i merrni edhe përvojat e vendeve tjera dhe do ta keni mbështjen tonë duke pasur parasysh faktin se është një institucion i rëndësishëm dhe profesional.

Kryetari – si Këshilli duhet ti hartoni kërkesat në bazë të nevojave të huaja dhe ne do ti shqyrtojmë në fazën e shqyrtimit të buxhetit. Për qështjet dhe problemet tjera që u diskutuan që ndërlidhen edhe me nevojën e ndryshimit dhe plotësimit të ligjit, kompetent është komisioni funksional.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni unanimisht, nxori këtë

Rekomandim

Komisioni i rekomandojë Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2015.

Mbledhja përfundoi në ora 17:30

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani